



DPK/DMP
01

03-3892/12
30.10.2012



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 14880/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Naim Zeqiri nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 5,6 par. 1 dhe 2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 si dhe neni 9 te Ligjit nr. 04/L-050 te Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave për te gjithë personat zyrtar,e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 17.10.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI : Naim Rexhep Zeqiri, i lindur më 28.11.1978 ne Prishtinë, ku dhe tani jeton ne rrugën Velania 7 nr. 19, udhëheq zyrës për komunikim ne Ministrin e zhvillimit ekonomike,i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse i pandehuri në cilësinë zyrtarit te lartë publik, udhëheq zyrës për komunikim ne Ministrin e zhvillimit ekonomike , nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë,i cili behtë me deklarimin e rregullt vjetor deri me datën 31.03.2012 të çdo viti kalendarik në Agjensionit Kundër Korrupsionit

Me këtë ka kryer vepër kundërvajtës nga 5,6 par. 1 dhe 2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 si dhe neni 9 te Ligjit nr. 04/L-050 te Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave për te gjithë personat zyrtar, andaj për këtë:

D E N O H E T

Me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) EURO. Gjjobën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së. No.1000-4300-7000-0518

Pagesa bëhet në ndonjëren agjenci për mbledhjen e të hyrave –bankë,përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata. Nëse brenda afatit të caktuar i pandehuri nuk e paguan gjobën e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 dite duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) EURO në një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur kurse në emër të paushallit i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 (pesë) EURO në afat të njëjtë sikurse gjobën në shërbimin e arkës së Gjykatës.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit , parashtroi kërkesën nr.01 -1604/2012 të dt 30.04.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtës kundër të pandehurit së përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur, ku është marrë Konkluzion.

Gjatë procedurës u dëgjua i pandehuri i cili në deklaraten e tij pohoj se sa i përket mbushjes se formularit për deklarimin pasurisë është unë e kam deklaruar çdo herë se kur kam fillaku te punoj në këtë pozitë nga viti 2008 për aplikim i pasurisë për neve ka qenë nga viti 2010 ku unë e kam lajmru pasurin se me dt. 12.04.2012 arsyeja me te cilën nuk e kam deklaruar me kohë është se unë e kam mbush formularin dhe ja kam lanë ariheves i cili e benë dërgimin shkresave dhe te gjitha akteve te tjera, ku unë kam mendua se ata e kanë derzu pasi qe me dt. 23.03.2012 kam qenë në detyrë zyrtare në Tiranë, dhe këto ishin arsye qe nuk e kam derzu formularin me kohë.

Gjyqtari pasi që administroj provat dhe të provuarit e kësaj çështje, në mënyrë të drejt dhe të plotë vërtetoj gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, andaj për këtë e shpalli fajtor dhe e dënoi si në diapozitiv të këtij aktvendimi. Me rastin e shqiptimit të dënimit Gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 te Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht peshën e kundërvajtjes së bërë, andaj ia shqiptoj këtë lloj të dënimit duke konsideruar se vetëm me këtë do të arrihet efekti pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtilla dhe të ngjashme. ,andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE

Fatmir Bekrami

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë,në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksa.